



## Udhëzues për plotësimin e LIBRIT TË BLERJES

**Data:** Shëno datën e faturës. Formati duhet të jetë: data / muaji / viti, p.sh. 13.01.2017. Kjo rubrikë është mandatore.

**Numri i faturës:** Shëno numrin e faturës së shitjes. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

**Emri i shitësit:** Shëno emrin e plotë të shitësit nga i cili është furnizuar blerësi, p.sh.. "XXXXX" SH.P.K. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

**Numri Fiskal i shitësit / Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit:** Shëno Numrin Fiskal të shitësit apo Numrin Unik të Regjistrimit të Biznesit – Shitësit. Numri Fiskal - formati është 9 shifror, fillon me 6... dhe përmban vetëm numra (p.sh. 600000001); Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit – formati është 9 shifror, fillon me 81... dhe përmban vetëm numra (p.sh. 810000123). Këtu mund të shkruash edhe Numër personal të Kosovës. Kjo rubrikë validohet sipas Numrit Fiskal/ Numrit Unik të Regjistrimit të Biznesit/ Numrit personal. Nuk është rubrikë mandatore.

**Numri i TVSH-së së shitësit:** Shëno numrin e TVSH-së së shitësit. Formati është 9 shifror, fillon me 3 dhe përmban vetëm numra (p.sh. 330000001). Validohet sipas Numrit të TVSH-së, nuk është rubrikë mandatore.

**[31] Blerjet dhe importet pa TVSH:** Shëno blerjet vendore dhe importet që nuk janë të ngarkueshme me TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[32] Blerjet dhe importet investive pa TVSH:** Shëno blerjet vendore dhe importet që konsiderohen investime dhe nuk janë të ngarkueshme me TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[33] Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme:** Shëno blerjet vendore dhe importet që janë të ngarkueshme me TVSH, por që nuk e kanë të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[34] Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme:** Shëno blerjet vendore dhe importet që konsiderohen investime të ngarkueshme me TVSH, por që nuk e kanë të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[35] Importet:** Shëno importet e ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[39] Importet investive:** Shëno importet investive të ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[43] Blerjet vendore:** Shëno blerjet vendore të ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[47] Blerjet investive vendore:** Shëno blerjet investive vendore të ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[53] Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 47 të Ligjit për TVSH, kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigohet sipas nenit 41.1. të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[57] Fatura e borxhit të keq e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 48 të Ligjit për TVSH, për faturat e borxhit të keq që lëshohen sipas nenit 43 të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[61] Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë:** Shëno rregullimin e zbritjeve sipas nenit 41 të Ligjit për TVSH kur përcakton më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme ka qenë më e ulët se sa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë. Po ashtu, sipas nenit 42 të Ligjit të TVSH-së vendos vlerën e TVSH-së së zbritshme në stoqet e mallrave me rastin e fillimit të aktivitetit ekonomik si person i tatueshëm i regjistruar për TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[65] E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me Ngarkesën e Kundërt:** Shëno të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme për blerjet e shërbimeve jashtë vendit, si dhe bartjen e detyrimit tatimor për TVSH brenda vendit tek pranuesi i furnizimit (aktualisht e zbatueshme në furnizimet e shërbimeve në lëminë e ndërtimtarisë brenda vendit) për të cilat aplikohet "Ngarkesa e Kundërt" sipas nenit 52 të Ligjit të TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[K1] TVSH e zbritshme me 18%:** Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (35+39+43+47+53+57+61+65) dhe i shumëzohet me normën standarde të TVSH-së, 18%.

**[37] Importet:** Shëno importet që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[41] Importet investive:** Shëno importet investive që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[45] Blerjet vendore:** Shëno blerjet vendore që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formati është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[49] Blerjet investive vendore:** Shëno blerjet investive vendore që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formati është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[51] Blerjet nga fermerët (aplikimi i normës së sheshtë):** Shëno blerjet nga fermerët vendor sipas skemës së veçantë për bujqit. Këtu vendosen vetëm blerjet nga personat të cilët janë të pajisur me numër identifikues nga MBPZHR. Formati është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[55] Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 47 të Ligjit për TVSH, kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigojen sipas nenit 41.1. të këtij Ligji. Formati është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[59] Fatura e borxhit të keq e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 48 të Ligjit për TVSH, për faturat e borxhit të keq që lëshohen sipas nenit 43 të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[63] Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë:** Shëno rregullimin e zbritjeve sipas nenit 41 të Ligjit të TVSH-së kur përcaktohet më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme ka qenë më e ulët se sa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë. Po ashtu, sipas nenit 42 të Ligjit të TVSH-së vendoset vlera e TVSH-së së zbritshme në stoqet e mallrave me rastin e fillimit të aktivitetit ekonomik si person i tatueshëm i regjistruar për TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[K2] TVSH e zbritshme me 8%:** Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (37+41+45+49+51+55+59+63) dhe i shumëzohet me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%.

**[67] Totali i TVSH-së së zbritshme me 18% dhe 8%:** Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (K1+K2).